



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1452 Prot.

Tiranë, më datë 28.12.2022

VENDIM

Nr. 574, datë 28.12.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 28.12.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Potencialit Arkeologjik, në kuadër të projektit “Rindërtim i objektit ekzistues 1 kat mbi tokë”, Brenda Kufirit të Zonës Arkeologjike “A”, Durrës, me aplikues Adlei Likmeta dhe zhvillues Indrit Nuredini;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2, nga DRTK Tiranë;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Eugen KALLFANI

